



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0188**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “PBC” SH.P.K. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ” me numër të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1, me 28/04/2026, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “PBC” SH.P.K. me nr. 2026/0188, e datës 25/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ” me numër të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1.
2. Anullohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ” me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1 të **kthehet ne rivlerësim.**
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “PBC” SH.P.K.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29/05/2025, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ” me numër të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1.

Me 10/03/2026, OE "PBC" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25/03/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "PBC" SH.P.K. me nr. 0188/2026 lidhur me aktivitetin "Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ" me numër të prokurimit: 206-25-4780-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

### **Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PBC" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:**

Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 18.03.2026, me të cilin nuk është trajtuar asnjë nga pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, por vetëm është pretenduar se: "Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe pas analizimit të plotë të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Vlerësimit konstaton se procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit", si dhe kundër vendimit për dhënien e kontratës të datës 06.03.2026.

Me vendimin e datës 18.03.2026, AK ka shkelur nenin 108/A dhe nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik, pasi që i njëjti nuk i ka trajtuar pretendimet tona ankimore në kërkesën për rishqyrtim. Po ashtu, ky vendim bie ndesh me nenin 7 të LPP-së, pasi cenon trajtimin e barabartë dhe transparencën procedurale, si dhe me nenet 59, 69 dhe 72 të LPP[1]së, në masën që AK ka mbrojtur një vlerësim të ofertës pa iu përgjigjur pretendimeve konkrete që lidhen pikërisht me përgjegjshmërinë e ofertës, sqarimet, dëshmitë dhe përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

Të gjitha pikat e kërkesës për rishqyrtim për vendimin për dhënien e kontratës, të datës 06.03.2026, mbesin të njëjta dhe po i përshekruajmë më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, nenin 27 paragrafi 4, nenin 56 paragrafi 1, nenin 59 paragrafët 2 dhe 4, nenin 72 paragrafët 1, 2 dhe 3, si dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 17.12, nenin 38 paragrafët 2 deri 5, nenin 40.2 dhe nenin 45 paragrafët 17, 18, 19 dhe 25 të Rregullores Nr. 001/2022, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, sepse ka cilësuar si të përgjegjshme një ofertë e cila nuk i ka përmbushur kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe të Dosjes së Tenderit. Kjo për faktin se tenderi mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, ndërsa AK gjatë vlerësimit nuk mund të ndryshojë, zbusë apo anashkalojë kërkesat dhe dëshmitë që i ka kërkuar vetë paraprakisht.

Faktet dhe dëshmitë i gjeni më poshtë:

Për Kapaciteti teknik dhe profesional Autoriteti Kontraktues në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit ka kërkuar që: OE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në dizajnimin, zhvillimin dhe implementimin në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) në vlerën e përgjithshme të projekteve minimum 250,000.00 € në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Se paku njëri nga projektet duhet të jetë në vlerën minimum 150,000.00 €. Mirëpo e ka vlerësuar si ofertë të përgjegjshme tenderin e OE Inspired Tech, edhe pse ky Operator Ekonomik:

1. Fare nuk ka dorëzuar dëshmi që e plotëson këtë kriter. Në fakt, ka dorëzuar:

a. Referencë nga kompania Sunnyhill Tech për punën që pretendohet se e ka kryer për Alletta Sales Platform AG, ku thotë se shuma e kontratës është 440,000 EUR, të nënshkruar nga Vita Hasani, në cilësi të CEO edhe pse e njëjta ka titull tjetër, sipas ueb faqes së kësaj kompanie. Mirëpo, nuk ka asnjë dëshmi të besueshme se çfarë ndërlidhje ka Sunnyhill Tech me Alletta Sales Platform. Përveç kësaj, dëshmitë e pagesave prezantojnë një total të pagesave dukshëm më të ulët sesa vlera e deklaruar e kontratës. Nga kjo rrjedh se ky projekte edhe më tutje nuk është përfunduar dhe se deklaratimet e palëve tingëllojnë të jenë fabrikate.

b. Ka dorëzuar dëshmi pagese nga Alletta Sales Platform AG, me vule dhe nënshkrim të Bankës Kombëtare Tregtare, në një format jashtë formatit që kjo bankë e lëshon – gjë që na bën të dyshojmë seriozisht për autenticitetin e saj – dhe kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues ta bëjë verifikimin e saj.

c. Gjatë kërkesave për sqarime Autoriteti Kontraktues ka pranuar një referencë tjetër nga Alletta Sales Platform e cila përbën ndryshim material të tenderit të dorëzuar e jo sqarim të dokumenteve të dorëzuara në procedurë.

2. Fare nuk ka dorëzuar dëshmi për:

a. Pozitën Menaxher i Projektit, ku në Dosjen e Tenderit është kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik të ofrojë CV me listën e projekteve të menaxhuara, si dhe është kërkuar minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Ndërsa CV-ja e dorëzuar për Ernest Culaj si Menaxher i Projektit nuk e përmban listën e projekteve të menaxhuara, ndonëse kjo ka qenë dëshmi e kërkuar shprehimisht nga AK në Dosjen e Tenderit. Pra, nuk është dorëzuar dokumenti në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga AK.

Po ashtu, nga CV-ja e dorëzuar për Ernest Culaj nuk dëshmohet qartë përvoja minimale prej 5 viteve pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). CV-ja paraqet përvojë të përgjithshme profesionale dhe pozita të ndryshme menaxheriale e teknike, por nuk identifikon dhe nuk dëshmon në mënyrë të qartë projektet konkrete të ngjashme të menaxhuara, kohëzgjatjen e tyre dhe faktin se ato kanë qenë të zhvilluara pikërisht në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

b. Për pozitën Zhvillues i Softuerit (Programer), Dosja e Tenderit kërkon minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në zhvillimin e softuerit të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Ndërsa CV-ja e dorëzuar për Ndriçim Idrizi, i përcaktuar si Zhvillues i Softuerit (Programer), dëshmon përvojë të përgjithshme në programim me teknologji si Java, Spring, GWT, Oracle, MySQL, NodeJS, PHP, si dhe referenca të kufizuara në ASP.NET, C# dhe MS SQL, por nuk e dëshmon përvojën specifike të kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit. Kriteri i vendosur nga AK nuk ka qenë përvojë e përgjithshme si zhvillues, por përvojë e dëshmuar dhe specifike në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Po ashtu, CV-ja e dorëzuar për Diana Llugaxhija, e përcaktuar si Zhvillues i Softuerit (Programer), dëshmon përvojë të përgjithshme në programim me teknologji si Java, SQL dhe C#, por nuk e dëshmon përvojën specifike të kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit.

Kriteri i vendosur nga AK nuk ka qenë përvojë e përgjithshme si zhvillues, por përvojë e dëshmuar dhe specifike në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Për pozitën Zhvillues i databazave, Dosja e Tenderit kërkon minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në zhvillimin e softuerit të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Ndërsa CV-ja e dorëzuar për Driton Prushi i përmban teknologjitë e kërkuara, por nuk dëshmon projekte të natyrës së ngjashme, respektivisht nuk e dëshmon përvojën specifike pas diplomimit sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

c. Për pozitën Zhvillues i databazave, Dosja e Tenderit kërkon minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në zhvillimin e softuerit të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Ndërsa CV-ja e dorëzuar për Driton Prushi i përmban teknologjitë e kërkuara, por nuk dëshmon projekte të natyrës së ngjashme, respektivisht nuk e dëshmon përvojën specifike pas diplomimit sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

d. Për pozitën Zhvillues i Web shërbimeve dhe Web API-ve, Dosja e Tenderit kërkon minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në zhvillimin e projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Ndërsa CV-ja e dorëzuar për Festinë Bytyçi i përmban teknologjitë e kërkuara, por nuk dëshmon projekte të natyrës së ngjashme, respektivisht nuk e dëshmon përvojën specifike pas diplomimit sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

3. Fare nuk ka dorëzuar Metodologjinë e propozuar dhe planin e punës edhe pse e njëjta është kërkesë decidive e Dosjes së Tenderit.

4. Fare nuk ka dorëzuar oferte teknike me rastin e dorëzimit të tenderit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, me parimin e trajtimit të barabartë dhe me rregullat për vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm.

Prandaj, bazuar në faktet dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-së i datës 18.03.2026, si dhe Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 06.03.2026, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 31/03/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe

pretendimeve sipas ankesës me nr. 0188/2026, ndërsa me datë 14/04/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0188/2026, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

**Lidhur me pretendimet e OE “PBC” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0188 ka vlerësuar si në vijim:**

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” me nr. të prokurimit: "206-25-4780-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, procedurë e hapur, lloji i kontratës shërbim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Vendimit B58 Njoftimi mbi rekomandimin e Operatorit Ekonomik (OE) Inspired Tech SHPK.

OE ankues është shpallë i pasuksesshëm.

Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se gjatë rivlerësimit shkelë dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 7, 27.4, 56.1, 72.1.2.4, 108/A, 69, 17. 12, 38.2.3.4.5, 40.2, 63, dhe neni 45 par. 17,18,19, dhe 25 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 002/2024.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit gjenden dy vendime të Panelit Shqyrtues me numrat: 883/25 dt: 20/10/2025 dhe 1270/25 dt: 19/02/2026, në të cilat vendime, ankues ka qenë OE i rekomanduar aktual “Inspiret Tech” SHPK.

*(Të gjitha pretendimet e ankesës janë të përshkruara lartë në raport, tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore)*

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket listës së projekteve të përfunduara, i njëjti pretendim ankimor është trajtuar në dy vendimet e PSH nr. 883/25 dhe 1270/25, për të cilën konsiderohet se pas sqarimeve të ofruara nga OE i rekomanduar, i plotëson kërkesat e DT-së.

Tutje, OE ankues ka parashtruar gjithashtu pretendime ankimore kundër OE të rekomanduar lidhur me përvojën e inxhinirëve si: Menaxherit, Programerëve, Zhvilluesit të bazave të të dhënave, i cili pretendon se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës të kërkuar për menaxherin 5 vite, dhe për inxhinierët e tjerë 3 vite.

Ekspertja shqyrtuese shpejton se, Autoriteti Kontraktues në DT si kërkesa 9.1 & 9.2 Aftësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë staf për kryerjen e shërbimeve si në vijim:

a. **1 (një) Menaxher të projektit** - I diplomuar në nga ndonjërin prej drejtimeve: Shkenca kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion.

Kërkohet përvoja e punës minimum 5 vite pas diplomimit (pranohet edhe nga niveli Bachelor) në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), i certifikuar me certifikate valide në PMP ose ekuivalente.

#### **Dëshmitë 2.**

a: Kopje e diplomës, CV me listën e projekteve të menaxhuara, Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Kopjen e certifikatës për menaxhim dhe vegzën përkatëse për verifikim online.

b. **Dy (2) Zhvillues të Softuerit (Programer)** – Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkenca kompjuterike, me përvojë pune minimum 3 vjeçare pas diplomimit, në zhvillimin e softuerit (programim) të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)

b: Kopje e diplomës, CV, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

c. **Një (1) zhvillues të Web shërbimeve dhe Web API-ve** - Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkenca kompjuterike, me përvojë pune minimum 3 vjeçare pas përfundimit të studimeve, në zhvillimin e projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

c: Kopje e diplomës, CV, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

d. **Një (1) zhvillues të databazave** - Baçelor i Inxhinierisë kompjuterike ose Baçelor i shkenca kompjuterike, me përvojë pune minimum 3 vjeçare pas përfundimit të studimeve, në zhvillimin e bazave të të dhënave projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

d. Kopje e diplomës, CV, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Rrjedhimisht, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet lista e stafit të angazhuar me kontratë mbi vepër, diploma, certifikatë PMP prej menaxherit të projektit, gjithashtu inxhinierët kanë të bashkangjitur CV në të cilat dëshmohet përvoja e punës, mirëpo të njëjtit nuk kanë dëshmuar me referencë projekte të ngjashme sipas kërkesës për periudhën 5 dhe 3 vjeçare, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar për faktin se AK konform nenit 52.7 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sipas CV-ve të ofruara, referencat ose dëshmi mbi përmbushjen e përvojës në zhvillim të

projekteve të ngjashme sipas përcaktimit në DT për pozicionet e kërkuara.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të OE ankues lidhur me mos dorëzim të metodologjisë së propozuar dhe planit të punës, si dhe oferta teknike, ekspertja shqyrtuese konsideron se OE i rekomanduar nuk mund të eliminohet konform nenit 56.3 të LPP-së, për faktin se nuk kanë qenë pjese e kërkesës në FDT, por janë kërkesa pas nënshkrimit të kontratës, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ju fal besimin e plotë, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ te QKKTGJ” me numër të prokurimit 206-25-4780-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhenie të kontrates dhe lenda të kthehet në ri-vlerësim, si dhe AK të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - PBC SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: